



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0738

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "As Tech" SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të "Komuna e Prishtinës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim dhe mirëmbajtja e Klimave ne objektin Komunal dhe Institucionet e tjera" me numër të prokurimit:616-24-5477-1-2-1, me 17/10/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "AsTech" SH.P.K. me nr. 2024/0738, e datës 15.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe mirëmbajtja e Klimave ne objektin Komunal dhe Institucionet e tjera" me numër të prokurimit "616-24-5477-1-2-1".
2. **Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 22.07.2024 nga Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe mirëmbajtja e Klimave ne objektin Komunal dhe Institucionet e tjera" me numër të prokurimit "616-24-5477-1-2-1"
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik AsTech SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 30.05.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me numër të prokurimit 616-24-5477-1-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për furnizim, me vlerë të parashikuar 50,000.00€.

Me datë 22.07.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë OE "Sabri Azemi B.I."

Me datë 27.07.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 05.08.2024.

Me datë 15.08.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar ankesë në OSHP.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues

Pretendimi nr. 1 – *Pretendimi ankimor sipas ankesës nr. 738/24 është se AK në kundërshtim me dispozita të LPP nuk i ka ofruar qasje në dokument e OE ankues, konkretisht nuk i është ofruar qasja në vendim për emrimin e komisionit vlerësues dhe raportin e komisionit vlerësues mbi të cilin raport edhe mbështetet vendimi i AK-së për eliminim të OE.*

Pretendimi nr. 2 – *Pretendimi tjetër ankimor është se AK pas kërkesës për rishqyrtim të OE tjetër pjesëmarrës në këtë aktivitet, e ka rivlerësuar lëndën duke eliminuar OE ankues pas kërkuar asnjë sqarim shtesë.*

Pretendimi nr. 3 – *Pretendimi tjetër ankimorë ka të bëjë me arsyen e liminimit të OE ankues, ku sipas AK-së nuk është ofruar CV për udhëheqësin e punishtes, i mungon së paku një kontratë, kontrate e ngjashme në tri vitet e fundit. OE ankues pretendon se kjo kërkesë ka mund të plotësohet me sqarime shtesë dhe i njëjti përmes ankesës në OSHP ka ofruar CV në e udhëheqësit të punishtes, si dhe referencë nga H&B Consulting me disa projekte, duke përfshirë edhe projektin me Milenium Foundation of Kosovo e vitit 2022.*

Pretendimi nr. 4 – *Pretendimi tjetër ankimorë ka të bëjë me arsryen e AK-së për eliminim ku sipas AK OE ankues ka ofruar vlerësimin e rriskut vetëm për tri pozita. OE ankues pretendon se ka ofruar vlerësimin e riskut në pajtim me kërkesat e dosjes, ndërsa sa i përket pozitive për udhëheqës të punishtes etj, të njëjtit nuk janë punëtor të rregullt të kompanisë dhe janë të angazhuar me para kontratë vetëm për këtë projekt.*

Pretendimi nr. 5 – *Pretendimi ankimor ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas komisionit vlerësues i njëjti ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta për pozicionet 43, 44 dhe 66. OE ankues pretendon se fillimisht nuk plotësohet kërkesa e rregullores për prokurim publik që për krahasim të çmimeve duhet të jenë së paku tri oferta. Po ashtu OE pretendon se çmimet e ofruara nga i njëjti janë çmime reale të tregut dhe është OE tjetër i cili ka ofruar çmime*

jonormalisht të larta për këto pozicione.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.08.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore ndërsa me datë 04.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesësisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“ Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar*

Lidhur me pretendimin nr. 2 - *“Pas analizimit të ofertës dhe të pretendimeve ankimore, vlerësojmë se arsyet e dhëna për eliminim të OE ankues në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe udhëzuesit për prokurim publik kanë mund të kërkohen informata shtesë përderisa OE ankues është çmim më të ulët. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 3 - *“Vlerësimi ekspertit është se në pajtim nenin 10-Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve UPP lidhur me nenin 69 të LPP - CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar Mund të kërkohen informata sqaruese. Po ashtu konsiderojmë se projekti me Milenium Foundation është natyrë e ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit. Në rast se AK ka pas dyshime në përmbajtje të referencës dhe CV-së, në pajtim me dispozitat e LPP-së ka mund të bëjë verifikimin e tyre. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 4 – *“Pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur i se njëjti ka ofruar vlerësimin e riskut ku përveç drejtorit dhe administratores është e pozita për serviser të pajisjeve elektroshtëpiake. Ky vlerësim i riskut konsiderojmë se është në pajtim me kërkesat e dosjes, pasi nuk vlerësimi i riskut bëhet vetëm për pozita/organogram të kompanisë. Staf i ofruar për këtë projekt me parakontrata (staf jo i rregullt) nuk ka sesi të jetë pjesë e vlerësimit të riskut të organogramit të kompanisë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 5 – *“Pas analizimit të ofertës së OE ankues dhe shkresave të lëndës, nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi të ofruar nga AK përmes të cilave ka vërtetuar çmimet reale të tregut mbi të cilat vlerëson çmime jo normalisht të ulëta çmime te OE ankues. Vlerësimi i AK-së më shumë duket të jetë bazuar në pretendimet e OE tjetër në kërkesë për rishqyrtim, çka konsiderojmë se është e pamjaftueshme, përveq kësaj pas hulumtimeve që kemi bërë sidomos për “Rregullueve frekuentiv” kemi gjetur se çmim i ofruar nga OE nuk është çmim jonormalisht i ulët me çmimet e tregut. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar”.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme sa i përket pretendimit ankimor nr. 1 dhe 4 ndërsa të paqëndrueshme tërësisht sa i përket pretendimeve të tjera ankimore. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimit ankimor nr. 1 dhe 4 ndërsa nuk i ka faluar besimin sa i përket pretendimeve të tjera.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur që sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, AK e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit OE ankues si tenderues të papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: *“për udhëheqësin e punishtes – Bachelor ose Inxhinier i dip. i termoenergjetikës i mungon CV e nënshkruar, CV nuk i plotëson kërkesat e AK, i mungon së paku një kontratë, kontratë e ngjashme e realizuar në tri vitet e fundit. Pikë tjetër që nuk e ka përmbushur OE As Tech është se në raportin e vlerësimit të riskut në ofertën e tij ka paraqitur vetëm 3 pozita: administratoren, drejtorin dhe servisuesin e pajisjeve shtëpiake. Po ashtu OE As Tech ka ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta në pozicionet 43, 44 dhe 66”.*

Tutje Paneli Shqyrtues ka gjetur se përmes kërkesës për rishqyrtim të drejtuar ndaj AK, të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë refuzuar si të pabazuara.

Sa i përket pretendimit të parë dhe të katërt ankimor, Paneli Shqyrtues ka gjetur se konstatimet e ekspertit shqyrtues janë pjesërisht të bazuara. Mirëpo as dokumentet për të cilat është kërkuar qasje (vendimi për formimin e komisionit dhe raporti vlerësues) dhe as fakti që në raportin vlerësues janë vendosur vetëm 3 punëtor nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit. Kjo për arsye se vendimi për formimin e komisionit vlerësues pranë AK dhe raporti vlerësues e manifestojnë procesin e vlerësimit mirëpo nuk ndikojnë procesin e vlerësimit në kuptim të interesit juridik të OE ankues. Ndërsa pjesa e raportit për vlerësimin e riskut të OE ankues ku janë evidentuar vetëm 3 punonjës, Paneli ka gjetur se kjo nuk është e gjetura e vetëm për të cilën OE është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Përtej kësaj nuk qëndron konstatuar nga eksperti shqyrtues se të gjithë punonjësit në listën e punonjësve të OE janë të angazhuar përmes parakontratave dhe nuk ka nevojë të evidentohen edhe në raportin për vlerësimin e riskut. Sidoqoftë raporti i vlerësimit të riskut ka pasqyruar gjendjen e punonjësve të OE ankues në kohën kur është realizuar procesi i vlerësimit të riskut. Ndërsa për AK duhet të jetë relevante vetëm gjendja e OE dhe dëshmitë dokumentare të dorëzuar përmes ofertës në kohën kur OE ka tenderuar për aktivitetin përkatës të prokurimit. Mirëpo përtej këtij këndvështrimi, përderisa në vijim janë konfirmuar të gjeturat tjera të AK sipas të cilave OE ankues është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm, konstatimet e ekspertit shqyrtues si të tilla nuk mjaftojnë për të kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim. Ndërsa për arsyet më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur vetëm pjesërisht besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore nr. 1 dhe nr. 4.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor duhet cekur se eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi është i bazuar për faktin gjatë rivlerësimit nuk janë kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesit. Me këtë rast duhet theksuar se kur një aktivitet i prokurimit kthehet në rivlerësim nuk ekzistojnë asnjë dispozitë ligjore që e detyron komisionin vlerësues të kërkojë patjetër sqarime shtesë në kuptim të nenit 72. Përkundrazi, komisioni ri/vlerësues është i pavaruar dhe duhet të vlerësojë mbi bazën e diskrecionit që ka nëse ka nevojë ose jo që sipas nenit 72 të LPP të kërkojë sqarime shtesë. Në rastin konkret komisioni ri/vlerësues ka vendosur për të kërkuar sqarime shtesë po ka realizuar vlerësimin vetëm mbi bazën e dëshmive dokumentare që kanë dorëzuar tenderuesit përmes ofertave përkatëse. Pra konstatimi i ekspertit shqyrtues se është dashur të kërkohen sqarime shtesë pa elaboruar se për çka duhet të kërkohen këto sqarime, është konstatim i mangët rrjedhimisht edhe i paqëndrueshëm të cilit Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin.

Sa i përket pretendimit të tretë ankimor, Paneli Shqyrtues nuk pajtohet aspak me konstatimin e ekspertit shqyrtues pasi që në rastin konkret nuk është se mungon CV për udhëheqësin e punishtes prandaj nuk aplikohet pika 10 e UPP “kur mungon CV – mund të kërkohet sqarime shtesë” në formën sikurse është cituar kjo pjesë nga eksperti shqyrtues. Në rastin konkret OE ankues ka dorëzuar CV për udhëheqësin e punishtes mirëpo CV nuk ka përmbushur kërkesat e AK pasi që në atë CV mungon së paku një kontratë e ngjashme e realizuar në tri vitet e fundit

sikurse që është kërkuar në dosjen e tenderit. Lidhur me këtë pjesë AK nuk ka pasur mundësi në kuptim të UPP që të kërkoj sqarime shtesë pasi që pika 10 e UPP “kur CV nuk përmbushë kërkesat e DT – refuzo tenderin pa kërkuar sqarime shtesë”. Ky fakt është konstatuar si i tillë edhe një vendimin e AK të dt. 22.07.2024. Rrjedhimisht OE ankues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe është i papërgjegjshëm në këtë pikë. Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin konstatimit të ekspertit shqyrtues dhe ka gjetur se pretendimi është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të pestë ankimor Paneli Shqyrtues ka analizuar me kujdes konstatimin e ekspertit shqyrtues dhe ka gjetur se në raportin e ekspertit shqyrtues nuk është elaboruar pretendimi ankimor në kontekstin nëse OE ankues ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta sa i përket pozicioneve nr. 43, 44 dhe 66. Në anën tjetër as OE ankues përmes ankesës nuk ka arritur që të prezantoj argumente të qëndrueshme në kuptim të nenit 41.8 dhe 41.9 të RRPP (“*ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara; elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet*”).

Paneli Shqyrtues potencon se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit duke marrë parasysh edhe elaborimet si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik*”. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkruesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 22.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera” me numër të prokurimit 616-24-5477-1-2-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsye të elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AS Tech SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: